

Aleksandar Paunoski është elektroinxhinier i diplomuar në Fakultetin Elektroteknik në Shkup, në vitin 2004, drejtimi i inxhinierisë elektrike. Gjatë vitit 2005 vazhdon arsimin në nivelin pasuniversitar në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe të Teknologjive të Informacionit në drejtimin: sistemet e transmetimit dhe distribuimit, financuar nga projekti TEMPUS. Punimin e magjistraturës e mbron në vitin 2008 me temë: Optimizimi i rasteve të tensionit -reaktive në sistemin elektroenergjetik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Karrierën profesionale e fillon në vitin 2006 në MEPSO, në Shërbimin e planifikimit strategjik dhe analizës, si inxhinier i analizave zhvillimore, ndërsa gjatë periudhës 2010-2014 emërohet si udhëheqës i Departamentit të planifikimit strategjik dhe analizave zhvillimore. Nga viti 2014 deri në vitin 2017 zë postin e Drejtorit për zhvillim dhe investime në termocentralet e Maqedonisë dhe anëtar i Këshillit Drejtues. Nga viti 2017 deri në vitin 2022 ka qenë menaxher i projektit në MEPSO. Gjatë periudhës 2022-2024, punon si inxhinier i analizave zhvillimore në një kompani konsulente ndërkombëtare me seli në Gjermani.

Gjatë veprimtarisë së tij, gjithashtu paraqitet si autor i më shumë se 20 punimeve shkencore brenda dhe jashtë vendit, të cilat kanë të bëjnë me fushat arsimore dhe shkencore: planifikimi dhe zhvillimi i sistemeve të transmetimit, analiza zhvillimore për implementimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë elektrike, si dhe si liberalizimi i tregjeve të energjisë elektrike.

Një nga autorët e Studimit për zhvillimin e rrjetit të transmetimit, të përgatitur nga MEPSO në vitin 2010, si dhe pjesëmarrës në përgatitjen e planit të parë 10-vjeçar për zhvillimin e Rrjetit Evropian të transmetimit, ndërsa në të njëjtën periudhë ai është një nga autorët e përcaktimit të metodologjisë dhe llogaritjes së kapaciteteve transmetuese për rajonin e Evropës Juglindore. Ndërmjet viteve 2014 dhe 2017 ka qenë drejtor i projektit: Park për elektranat me erë- Bogdanci dhe u vu në punë termocentrali i parë me erë në vend. Në të njëjtën kohë u përfunduan edhe projektet si në vijim: rivitalizimi i 6 hidrocentraleve, si dhe filloi projekti i Ngrohtores së Manastirit, Novacit dhe Mogillës.

Gjatë periudhës së kaluar, shfaqet si autor ose bashkëautor i një numri të madh studimesh rajonale në fushën e veprimit dhe menaxhimit të sistemeve elektroenergjetike.

Fushat e interesit:

- Planet zhvillimore dhe investimet në rrjetin e transmetimit
- Analizat e rrjedhës së fuqisë, qëndrueshmërisë së tensionit
- Kompensimi i fuqisë reaktive dhe menaxhimi i sistemit elektroenergjetik
- Analiza e qarqeve të shkurtra dhe defekteve në SEE
- Modelet dinamike të rrjeteve të transmetimit dhe stabiliteti tranzit
- Integrimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe sistemeve të baterive
- Zhvillimi dhe zbatimi i rregullave të rrjetit për transmetimin e energjisë elektrike përfshin zhvillimin e planeve për zhvillimin e SEE, futjen e metodologjive të reja dhe llogaritjen e kapaciteteve transmetuese, stabilitetin statik dhe kalimtar të SEE, paqëndrueshmërinë e tensionit dhe masat zbutëse.
- Përlllogaritja e kapaciteteve transmetuese dhe menaxhimi i kongjestionit në sistemet e transmetimit